

*Këshillues  
Leforolaj*



**KUVENDI**  
NR 347 DATE 31.01.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KUVENDI**  
*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**Lënda:** Kërkesë për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Lindita Nikolla.

**Drejtuar:** Këshillit për Legjislacionin.

**Këtu**

Të Nderuar kolegë,

Me urdhërin nr. 4, datë 24.01.2023, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ka urdhëruar: “I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 26.01.2023, ora 11:00. II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë: ...; III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet. IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.” [Prova nr. 1 – Urdhëri nr. 4, datë 24.01.2023].

Në përmbajtje të rendit të ditës ishte miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16.01.2023, njoftime, dy pyetje për ministren e Arsimit dhe Sporteve nga deputetja Erisa Xhixho, interpelancë me ministren e Kulturës nga deputetja Ina Zhupa, miratimi i një akti normativ, pesë projektligje, tre projektvendime dhe diskutime për çështje jashtë rendit të ditës. [Prova nr. 2 – Rendi i ditës i seancës plenare, 26 janar 2023, ora 11:00]

Urdhëri për zhvillimin e seancës plenare, së bashku me rendin e ditës, iu është njoftuar deputetëve nëpërmjet postës elektronike zyrtare nga Znj. Adelaida A. Hakani, me detyrë drejtor i Shërbimit të Seancës Plenare, në datën 24.01.2023, ora 15:25. [Prova nr. 3 – Email-i i datës 24.01.2023, ora 15:25, i Znj. Adelaida Hakani]

Pas njoftimit të urdhërit dhe rendit të ditës, deputetët janë regjistruar në sekretari për të diskutuar për çështjet e përfshira në rendin e ditës. Nga dokumenti i shpërndarë nga sekretaria për grupet parlamentare dhe mediat në datën 26.01.2023, ora 11:37, rezulton se ishin regjistruar për të diskutuar 43 deputetë për pikën 6; 11 deputetë për pikën 7; 9 deputetë për pikën 8; 5 deputetë për pikën 10; 5 deputetë për pikën 11; 7 deputetë për pikën 12; 2 deputetë për pikën 13; 2 deputetë për çështje jashtë rendit të ditës. [Prova nr. 4 – Lista e folësve për seancën plenare, datë 26 janar 2023]

Në seancën plenare të datës 26.01.2023, të filluar në orën 11:17, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ka njoftuar rendin e ditës dhe më pas ka filluar diskutimi sipas pikave të rendit të ditës. Kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Z. Enkelejd Alibeaj ka kërkuar që, në mbështetje të nenit 47, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, të ishte i pranishëm kryeministri në seancën plenare. Kjo kërkesë nuk është marrë parasysh dhe më pas një grup deputetësh kanë parashtruar kërkesën për ndryshimin e rendit të ditës, duke kërkuar që të përfshihet në rendin e ditës diskutimi për çështjen penale të ish-agjentit të FBI-së, Charles McGonigal. Ky propozim është rrëzuar me shumicë votash nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

Duke qenë se ndaj kërkesës së bërë nga kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, nuk ka pasur asnjë përgjigje, deputetët e pakicës parlamentare kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur praninë e kryeministrit në sallën e seancës plenare. Kryetarja e Kuvendit, duke iu mohuar të drejtën për pyetje deputetes Znj. Erisa Xhixho dhe të drejtën për interpelancë deputetes Znj. Ina Zhupa, ka filluar me diskutimin e projektligjeve. Lidhur me projektligjet dhe projektvendimet, kryetarja e Kuvendit nuk i ka dhënë asnjë deputeti, që kishte regjistruar emrin për diskutim në sekretari, të drejtën për të diskutuar. Pas një prezantimi të shkurtër të projektligjeve nga ministrat, është proceduar me votimin e tyre nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. [Prova nr. 5 – Video-regjistrimi i seancës plenare, datë 16.01.2023, ora 11:00]

Duke vepruar në këtë mënyrë, kryetarja e Kuvendit, në shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, iu ka mohuar deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të drejtën për pyetje, të drejtën për interpelancë, të drejtën për të diskutuar lidhur me çështjet e rendit të ditës dhe jashtë rendit të ditës. Në vijim, do të analizojmë shkeljet konkrete të kryera nga ana e kryetares së Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla.

**Shkelja nr. 1:** Rregullorja e Kuvendit sanksionon të drejtën e cdo deputeti për t'i drejtuar pyetje kryeministrit ose anëtarit të Këshillit të Ministrave (shih nenin 90). Kryeministri dhe anëtarët njoftohen për pyetjet e bëra dhe janë të detyruar t'u përgjigjen brenda 3 javëve nga paraqitja e tyre (shih nenin 91), në fillim të seancës plenare (shih nenin 92). Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se kryetari i Kuvendit siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe anëtarëve të tij (shih nenin 76). Duke i mohuar të drejtën për pyetje deputetes Znj. Erisa Xhixho, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ka vepruar në shkelje të rëndë të nenit 76 të Kushtetutës dhe nenit 90 të Rregullores së Kuvendit.

**Shkelja nr. 2:** Rregullorja e Kuvendit sanksionon të drejtën e cdo deputeti për të zhvilluar interpelancë me kryeministrin dhe cdo anëtar të Këshillit të Ministrave. Deputeti, që ka kërkuar interpelancën, i jepet e drejta e fjalës për 7 minuta, dhe pas deklarimit të anëtarit të Këshillit të Ministrave, deputeti e merr sërish fjalën për 15 minuta (shih nenin 96). Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se kryetari i Kuvendit siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe anëtarëve të tij (shih nenin 76). Duke i mohuar të drejtën për interpelancë deputetes Znj. Ina Zhupa, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ka vepruar në shkelje të rëndë të nenit 76 të Kushtetutës dhe nenit 96 të Rregullores së Kuvendit.

**Shkelja nr. 3:** Rregullorja e Kuvendit sanksionon se cdo deputet që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës, duhet të regjistrohet në sekretari para fillimit të seancës plenare. Vetëm kur deputeti nuk është i pranishëm në sallë konsiderohet se ai ka hequr dorë nga

diskutimi. Pasi përfundon lista e diskutuese, u jepet fjala kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare (shih nenin 46). Deputeti ka të drejtë të flasë për 10 minuta, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe (shih nenin 48). Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se kryetari i Kuvendit siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe anëtarëve të tij (shih nenin 76). Duke i mohuar të drejtën e fjalës të gjithë deputetëve që ishin regjistruar për të diskutuar lidhur me çështjet e përfshira ose të papërfshira në rendin e ditës (shih provën nr. 4), kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ka vepruar në shkelje të rëndë të nenit 76 të Kushtetutës dhe nenit 46 të Rregullores së Kuvendit.

Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar se Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve (shih nenin 75). Ndërsa, Rregullorja e Shqipërisë ka parashikuar se kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit i paraqitet Këshillit të Legjislacionit, i cili paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe në mënyrë të motivuar për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë, nga jo më pak se 28 deputetë (shih nenin 114).

Kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla, me qëllim të vetëm mbrojtjen politike të Edi Ramës, të kapur në flagrancë nga drejtësia amerikane se ka korrumpuar dhe bashkëpunuar me një agjent të FBI-së të lidhur me Rusinë, vendosi në paligjshmëri dhe arbitraritet të mbyllë Parlamentin. Ndërsa drejtësia amerikane agjësoi politikisht Edi Ramën, duke faktuar para botës mbarë lidhjen e tij korruptive me një zyrtar të FBI-së, të lidhur me Rusinë, kryetarja e Kuvendit asgjësoi Parlamentin për llogari të Edi Ramës.







Kështu, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla, duke iu mohuar deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të drejtën për pyetje, të drejtën për interpelancë dhe të drejtën për të diskutuar lidhur me çështjet e përfshira apo të papërfshira në rendin e ditës, ka vepruar në shkelje të rëndë të nenit 76 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe neneve 90, 96 dhe 46 të Rregullores së Kuvendit, duke përdhosur parlamentarizmin dhe minuar funksionimin demokratik të Kuvendit. Në këto kushte, Këshilli për Legjislacionin duhet të fillojë menjëherë procedurën për shkarkimin e saj nga detyra.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 75, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 114, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, përfundimisht, kërkojmë shkarkimin e menjëhershëm nga detyra të Kryetares së Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Me konsideratë,

#### DEPUTETËT

- |   |   |
|---|---|
| 1. <u>ENKELEJTA ACIBEAJ</u>  | 15. <u>Saimir Zogaj</u>    |
| 2. <u>Gazment Barolli</u>    | 16. <u>Blodan Velburi</u>  |
| 3. <u>Leftar Gërliterye</u>  | 17. <u>Ferit Durrës</u>    |

4. Endi Ikhla
5. Irbe Idris
6. Plumeto Cukh Ium
7. AMDA ULLIRI
8. Krosnikh Sokolov
9. Pernelenev d. Kozj
10. Xicel Mary Jefe For
11. Trolola Bomo
12. Cheri Gyerepi
13. Merita Bakum
14. Sueta A

18. Stany Rosa Lam
19. Seloshin Yumpli
20. Orjola Parzari Bera
21. Kastriot Iroli Labyroze
22. Ido Sheri
23. Petit Adqlebury
24. dashas Sula
25. Zef Hila
26. Ara Asan
27. Protoni Vela Asteli
28. Ma Zhupa